

	Të dhënat e pacientit (Vendosni këtu etiketën ngjitëse)
Informacion për Pacientët dhe Leje për Operacionin për Zëvendësimin e plotë të Kyçit të Kockës së Legenit Ref: INFOrm4U OS01	

Çfarë është sëmundja e artritit?

Sëmundja e artritit shfaqet në forma të ndryshme tek një ose disa kyçe të gjymtyrëve dhe shkakton dëmtim të vazhdueshëm të tyre.

Kirurgu juaj ka rekomanduar të bëni operacion të plotë për zëvendësimin e kyçit të legenit. Megjithatë, vendimi për t'u operuar ose jo është në dorën tuaj dhe për t'ju ndihmuar të vendosni, lexoni këtë dokument që përmban informacion të mjaftueshëm mbi dobinë dhe rreziqet e këtij operacioni. Në qoftë se keni pyetje të tjera, përgjigjet e të cilave nuk i gjeni në këtë dokument, pyesni kirurgun tuaj ose ndonjë nga anëtarët e personelit shëndetësor.

Si krijohet artriti?

Lloji më i përhapur i artritit është osteoartriti, që shkakton konsumimin e vazhdueshëm të kyçeve. Në disa raste kjo ndodh si rezultat i dëmtimeve të mëparshme, por zakonisht nuk dihen shkaqet. Llojet e tjera të artritit shoqërohen me ënjtje të dukshme të kyçeve dhe përfundimisht shkakton dëmtimin e rëndë të tyre. Lloji më i përhapur i artritit me ënjtje është artriti rumatoid.

Artriti zhduk kërcin që mbulon sipërfaqen e kyçeve dhe dëmton kockën që ndodhet nën të. Ai shkakton dhembje kyçesh, shtangësi dhe vështirësi në lëvizjet normale.

A ka kurim tjetër përveç kryerjes së këtij operacioni?

Për ta lehtësuar dhembjen dhe për ta ulur ënjtjen merren tableta paracetamoli dhe ibuprofeni. Ushtrimet e rregullta dhe të lehta ndihmojnë për ta ulur shtangësinë në kyçin e kockës së legenit të prekuar nga artriti.

Për të ecur më lehtë, mund të mbani një bastun në anën tjetër të kyçit të dobët si edhe të mbathni një këpucë më të lartë në anën e kyçit të dobët.

Gjilpërat me steroidë në kyçin e kockës së legenit pakësojnë për disa muaj dhembjet dhe shtangësinë, por përsëritja e shpeshtë e tyre mund të shkaktojë veprime dytësore. Të gjitha këto masa humbasin gradualisht efektin e tyre; artriti keqëson gjendjen shëndetësore dhe në këtë moment operacioni për zëvendësimin e kyçit të kockës së legenit shihet si një rrugëzgjdhje.

Çfarë ndodh në qoftë se vendos të mos e bëj operacionin?

Artriti i kyçit të kockës së legenit keqëson më tej gjendjen shëndetësore, por kjo nuk ndodh në të gjitha rastet. Ai nuk është kërcënues për jetën, por mund të shkaktojë invaliditet. Simptomat e artritit nganjëherë keqësohen më shumë, sidomos kur moti është i ftohtë.

Si bëhet operacioni?

Operacioni i zëvendësimit të plotë të kyçit të kockës së legenit përfshin heqjen e kokërdhokullit të dëmtuar dhe të zgavrës së kyçit të legenit dhe zëvendësimin e tyre me një sferë dhe zgavër artificiale prej metali, plastike, qeramike ose me një kombinim të këtyre materialeve (shih figurën 1).




Figura 1.

Zëvendësim i kyçit të kockës së legenit

	© Copyright 2003 EIDO Healthcare Ltd	INFOrm4U (OS01) Faqja 1 E vlefshme deri më korrik 2004
---	--	--



Zëvendësimi i kyçit të kockës së legenit bëhet në mënyra të ndryshme dhe kirurgu juaj do ta diskutojë me juve se cila nga metodat është më e përshtatshme për juve. Kyçi, që do të zëvendësohet, futet në të çarën e bërë në pjesën e jashtme të legenit. Ai fiksohet me çimento akrilike ose me shtresa speciale në kockën e legenit dhe të kofshës të cilat ngjiten menjëherë. Anestezisti juaj do ju flasë për llojet e ndryshme të anestezeve dhe do jua rekomandojë atë që është më e përshtatshme në rastin tuaj.

Çfarë mund të bëj unë që operacioni të dalë me sukses?

- **Ndryshime në mënyrën e jetesës**

Në qoftë se pini duhan, ndalojeni menjëherë. Prova të mjaftueshme kanë vërtetuar se po të ndalohet duhani disa javë ose shumë kohë para dhënies së anestezeve të përgjithshme, ulët rrezikun e ndërlikimeve. Nëse jeni mbi peshë, duke rënë nga peshë do ta ulni rrezikun e ndërlikimeve.

- **Mjekim**

Vazhdoni t'i përdorni ilaçet e dhëna deri sa t'ju këshillojnë t'i ndërprisni.

Nëse pini **warfarin**, duhet ta ndaloni para operacionit. Mos harroni t'i thoni doktorit që pini warfarin dhe ndiqni këshillat që do t'ju japin për ndalimin e tij.

Çfarë rreziqesh apo ndërlikimesh mund të ketë?

Ne do të përpiqemi që operacioni juaj të dalë me sukses. Ka mundësi që t'ju caktojme të merrni ilaçe për ta zvogëluar rrezikun e ndërlikimeve të mundshme. Shumica e operacioneve dalin me sukses dhe me pak ndërlikime.

Megjithatë, çdo procedurë shoqërohet nga rreziqet dhe ndërlikime të mundshme. Më poshtë do të gjeni rreziqet dhe ndërlikimet që shoqërojnë këtë operacion. Në qoftë se nuk kuptoni diçka, pyesni doktorin tuaj. Rreziqet dhe ndërlikimet ndahen në tri kategori.

1. Ndërlikime të anestezeve
2. Ndërlikime të përgjithshme të çdo operacioni
3. Ndërlikime të këtij operacioni

1. Ndërlikime të anestezeve

Anestezisti juaj do t'ju tregojë për rreziqet që paraqet anestezia.

2. Ndërlikime të përgjithshme të çdo operacioni

- **Dhembje**, që është karakteristikë e çdo operacioni. Për t'ju lehtësuar dhimbjet do ju japin disa ilaçe, të cilat duhet t'i pini sipas udhëzimeve të dhëna. Ato do ju ndihmojnë për të lëvizur më me lehtësi sipas këshillave të dhëna.
- **Gjakderdhje**, e cila mund të ndodhë gjatë operacionit ose pas tij. Më pas ka mundësi të ketë nevojë për transfuzion gjaku.
- **Shenjë e shëmtuar** por zakonisht plaga e operacionit për zëvendësimin e kyçit të kockës së legenit mbyllet mirë duke lënë një shenjë jo të shëmtuar.
- **Mpiksje gjaku** në këmbë (trombozë) (probabiliteti: 1 në 40), e cila mund të kalojë nëpërmjet gjakut në mushkëri (embol) ku shkatëron vështirësi në frymëmarrje (probabiliteti: 1 në 250). Shumë shpejt pas operacionit do t'ju nxisin të ecni dhe mund t'ju bëjnë gjilpëra për ta ulur rrezikun e shfaqjes së mpiksjeve të gjakut.
- **Vështirësi me urinimin** kur mund t'ju duhet të përdorni për një dy ditë një kateter.

3. Ndërlikime të këtij operacioni

- **Dëmtim i nervave** rreth zonës së kyçit të kockave të legenit, mpirje ose dhembje në pjesë të ndryshme të këmbës (probabiliteti: 1 në 100).
- **Infeksion**, i cili për disa muaj mund të shkaktojë lirshmërinë dhe mosfunksionimin e kyçit të zëvendësuar. Për ta luftuar infeksionin mund të bëhen një ose dy operacione të tjera (probabiliteti: 1 në 70).
- **Lirshmëri**, por pa infeksion, e kyçit të zëvendësuar, i cili ka nevojë për t'u operuar përsëri (probabiliteti: 1 në 40 gjatë pesë viteve, pas operacionit).
- **Zhvendosje** të kyçit të zëvendësuar, që nëse ndodh shpesh, ka nevojë për operacion tjetër (probabiliteti: 1 në 25 gjatë pesë viteve, pas operacionit).
- **Konsumim** të kyçit të zëvendësuar, që varet nga pesha trupore dhe se sa aktiv mund të jeni. Në një situatë të tillë ai duhet zëvendësuar. Duke marrë për bazë 20 operacione të zëvendësimit të kyçit të kockës së legenit, rezulton se 17 prej tyre zgjasin pesëmbëdhjetë vjet.
- **Njëra këmbë më e shkurtër se tjetra** dhe për këtë duhet shtuar lartësia e këpucës. Kirurgu do të synojë ta barazojë gjatësinë e këmbëve, por kjo nuk është gjithmonë e mundur, sidomos kur ndryshimi para operacionit ka qenë i madh.

Kur do të shërohem?

• Në spital

Pas operacionit do t'ju transferojnë në dhomën e rimëkëmbjes dhe pastaj në pavijon. Duke filluar nga dita e dytë pas operacionit, fizioterapistët do t'ju ndihmojnë të filloni të ecni dhe do t'ju mësojnë si të kujdeseni për kyçin e ri të kockës së legenit. Shumica e pacientëve kthehen në shtëpi pas shtatë ose dhjetë ditësh. Megjithatë, doktori mund t'ju rekomandojë të qëndroni pak më gjatë. Nëse ju shqetëson gjë në spital ose shtëpi, pyesni një nga pjestarët e ekipit për kujdes shëndetësor që do t'ju sigurojnë nëse jeni mirë ose do ta zbulojnë dhe kurojnë ndonjë nga ndërlikimet që mund të kenë.

• Kryerja e aktiviteteve normale

Kirurgu, fizioterapistët dhe terapistët tuaj të punës do t'ju këshillojnë se kur mund t'u ktheheni aktiviteteve tuaja normale. Duhet të tregoni kujdes të madh për kyçin e ri të kockës së legenit dhe t'i shmangni rrezikut ose problemeve që mund të shkaktojnë dëmtimin e tij.

Mos ngisni makinën derisa të jeni në gjendje ta kontrolloni atë në raste urgjente por së pari duhet të kontrolloni me kompaninë e sigurimit.

• E ardhmja

Shumica e pacientëve shërohen plotësisht, kanë dhembje të pakta dhe lëvizin mirë. Megjithatë, një kyç artificial nuk është njëllë si kyçi natyral dhe është e rëndësishme që të kujdeseni për të për një kohë të gjatë.

Përmbledhje

Problemi i artritit të kyçit të legenit nuk është i rrallë. Zëvendësimi i kyçit të legenit përmirëson jetesën e njerëzve që kanë vuajtur nga dhembje të forta, shtangësi dhe invaliditet. Operacioni është i sigurt dhe me rezultat, megjithatë mund të ketë rreziqe ose ndërlikime, të cilat duhet t'i dini përpara se të vendosni për ta bërë ose jo atë. Këto njohuri ndihmojnë edhe në zbulimin e hershëm dhe kurimin në kohë të sëmundjes.

Për informacion të mëtejshëm

Informacion të mëtejshëm mund të merrni nga:



- NHS Direct në këtë numër: 0845 46 47 (0845 606 46 47 - textphone) dhe në internet: www.nhsdirect.nhs.uk
- *Arthritis Research Campaign* (Fushata për Studime Mjekësore për Artritin) në numrin e telefonit: 0870 850 500 dhe në internet në këtë adresë: www.arc.org.uk
- 'Osteoarthritis - Diseases & Conditions A-Z' (Osteoartriti – Sëmundjet dhe Gjendjet Shëndetësore A-Z) në internet në adresën: www.mayoclinic.com
- American Academy of Orthopaedic Surgeons (Akademia Amerikane e Kirurgëve Ortopedikë) në: www.aaos.org
- www.eidohealthcare.com

Falënderimet tona:

Autor: Z. Stephen Milner DM FRCS (Tr. & Orth.) Ilustrimet: "Lifeart Surgery" © 2001 (Lippincott, Williams and Wilkins), Hannah Ravenscroft RM

Ky dokument u përgatit vetëm për qëllime informuese dhe duhet ta lexoni së bashku ose në lidhje me çfarëdo këshillë të dhënë nga punonjësit tuaj përkatës të shëndetësisë.



© Copyright 2003
EIDO Healthcare Ltd

INForm4U (OS01)
Faqja 4
E vlefshme deri më korrik 2004

